

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 4 (katër) vende pune për personel akademik në Departamentin e Shkencave të Tokës pranë Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave si më poshtë:

1 (një) vend pune për personel akademik në pozicionin “Lektor” në fushën e Sedimentologjisë dhe Paleontologjisë, pranë Departamentit të Shkencave të Tokës.

Kandidati duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

1. Të ketë diplomë 3+2 (Bachelor + Master Shkencor) ose sipas sistemit 5 (pesë) vjeçar, në fushën e Inxhinierisë Gjeologjike, ose diplomë Master i shkencave në Biologji, ose diploma ekuivalente me to, të fituara jashtë vendit.
2. Nota mesatare e ponderuar e studimeve universitare (Bachelor + Master i Shkencave ose për sistemet 5-vjeçare + Master, nëse ka), të jetë ≥ 8 (më e madhe ose e barabartë me 8).
3. Të ketë gradën shkencore “Doktor” në këtë fushë.
4. Të zotërojë dëshmi/certifikatë të mbrojtjes të një nga pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane ose spanjolle. Preferohet gjuha angleze.
5. Preferohet kandidati që ka artikuj të botuar në Revista Shkencore me Bord Editorial dhe Kod ISSN si dhe referime shkencore të paraqitura në Konferenca Shkencore dhe të botuara në *Proceedings*, me kod ISBN, në këto fusha.
6. Eksperienca mësimdhënëse në grup-lëndët e Paleontologjisë ose Sedimentologjisë përbën përparësi.

1 (një) vend pune për personel akademik në pozicionin “Asistent Lektor” në fushat e Gjeologjisë Strukturore dhe Tektonikës, pranë Departamentit të Shkencave të Tokës.

Kandidati duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

1. Të ketë diplomë 3+2 (Bachelor + Master Shkencor) ose sipas sistemit 5 (pesë) vjeçar në Inxhinieri Gjeologjike, Inxhinieri Gjeoinformatike, ose diploma ekuivalente me to, të fituara jashtë vendit.
2. Nota mesatare e ponderuar e studimeve universitare (Bachelor + Master i Shkencave ose për sistemet 5-vjeçare + Master, nëse ka), të jetë ≥ 8 (më e madhe ose e barabartë me 8).
3. Të zotërojë dëshmi/certifikatë të mbrojtjes të një nga pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane ose spanjolle. Preferohet gjuha angleze.
4. Preferohen kandidatët të cilët janë studentë doktorate në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, ose që kanë kryer kurse kualifikimi brenda/jashtë vendit si dhe ata që kanë eksperiencë profesionale në fushën për të cilën aplikojnë.
5. Aftësi të tjera të rëndësishme:
 - Aftësi shumë të mira komunikuese.
 - Aftësi për të punuar në grup dhe për të kontribuar në një mjedis bashkëpunues.
 - Njohuri shumë të mira kompjuterike (Paketa Office, GIS, ArcGis etj).

1 (një) vend pune për personel akademik në pozicionin “Asistent Lektor” në fushat e Mineralogjisë dhe Petrografisë pranë Departamentit të Shkencave të Tokës.

Kandidati duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

1. Të ketë diplomë 3+2 (Bachelor + Master Shkencor) ose sipas sistemit 5 (pesë) vjeçar në Inxhinieri Gjeologjike, Inxhinieri Gjeoinformatike, ose diploma ekuivalente me to, të fituara jashtë vendit.
2. Nota mesatare e ponderuar e studimeve universitare (Bachelor + Master i Shkencave ose për sistemet 5-vjeçare + Master, nëse ka), të jetë ≥ 8 (më e madhe ose e barabartë me 8).
3. Të zotërojë dëshmi/certifikatë të mbrojtjes të një nga pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane ose spanjolle. Preferohet gjuha angleze.
4. Preferohen kandidatët të cilët janë studentë doktorate në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, ose që kanë kryer kurse kualifikimi brenda/jashtë vendit si dhe ata që kanë eksperiencë profesionale në fushën për të cilën aplikojnë.
5. Aftësi të tjera të rëndësishme:
 - Aftësi shumë të mira komunikuese.
 - Aftësi për të punuar në grup dhe për të kontribuar në një mjedis bashkëpunues.
 - Njohuri shumë të mira kompjuterike (Paketa Office, GIS, ArcGis etj).

1 (një) vend pune për personel akademik në pozicionin “Asistent Lektor” në fushën e Gjeofizikës, pranë Departamentit të Shkencave të Tokës.

Kandidati duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

1. Të ketë diplomë 3+2 (Bachelor + Master Shkencor) ose sipas sistemit 5 (pesë) vjeçar në Inxhinieri Gjeologjike (në të gjitha profilet), Inxhinieri Gjeofizike, Fizikë, Inxhinieri Fizike, ose diploma ekuivalente me to, të fituara jashtë vendit.

2. Nota mesatare e ponderuar e studimeve universitare (Bachelor + Master i Shkencave ose për sistemet 5-vjeçare + Master, nëse ka), të jetë ≥ 8 (më e madhe ose e barabartë me 8).
3. Të zotërojë dëshmi/certifikatë të mbrojtjes të një nga pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane ose spanjolle. Preferohet gjuha angleze.
4. Aftësi të tjera të rëndësishme:
 - Aftësi shumë të mira komunikuese.
 - Aftësi për të punuar në grup dhe për të kontribuar në një mjedis bashkëpunues.
 - Njohuri shumë të mira kompjuterike (Paketa Office, GIS, ArcGis etj).

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet (origjinal ose kopje të noterizuar) si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimi (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje e gradës shkencore “Doktor”;
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton titujt dhe gradat, trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshmi e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **28.02.2025** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.